



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Diasporës/Ministarstvo za Diasporu/Ministry of Diaspora

DEPARTAMENTI I POLITIKAVE TË DIASPORËS

PROJEKT

**KAMPI SHKOLLOR VEROR I FËMIJËVE NGA DIASPORA "TA NJOHIM
ATDHEUN"**

**Ministria e Diasporës, në bashkëpunim me subjektet e mësimit plotësues,
organizojnë projektin e përbashkët të shkollës verore-kampi veror i fëmijëve nga
diaspora "Ta njohim atdheun"**

Prishtinë

(2013)

Qëllimi i projektit:

Në diasporën shqiptare ekziston një numër shumë i madh i të rinjve, të cilët për shumë arsye nuk kanë pasur mundësi të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me atdheun e tyre: Kosovën dhe Shqipërinë, prandaj është vlerësuar e nevojshme që të organizohen edhe kampe-shkolla verore, që do t'u mundësonin të krijojnë lidhje të reja shoqërore, si dhe ta njohin atdheun. Ky aktivitet prashihet me PVP për vitin 2013 të MeD dhe me Planin Strategjik të MeD 2012-2014 -Mendohet se nëpërmjet këtij kampi veror do të krijohet një lidhje më e fuqishme me vendin dhe se kjo ndjenjë mund të ndikojë edhe më shumë në vendimet e tyre për kthim në atdhe. Në kampin veror do të ketë aktivitete të shumta, që do të jenë në funksion të edukimit të tyre me ndjenjën e dashurisë dhe të

respektit për vendin dhe për njerëzit; me tolerancë për njëri-tjetrin etj.-Gjatë qëndrimit të tyre në kamp, do të mbahen shumë aktivitete që përfshijnë tema të ndryshme.

Arsyetim:

Organizimi i këtij aktiviteti është i rëndësishëm dhe ndikon drejtpërsëdrejti te nxënësit mërgimtarë që të njihen me atdheun, t'i mësojnë dhe t'i thellojnë njohuritë për identitetin e tyre, kulturën, historinë e vendit të tyre dhe, para së gjithash, ta mësojnë gjuhën amtare në shkallë sa më të lartë. Me këtë projekt, Ministria e Diasporës përmbush edhe një objektiv të planit të punës për vitin 2013 dhe një nga synimet kryesore për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit të pjesëtarëve të diasporës, në radhë të parë të të rinjve.

Realizimi

Emri i projektit: Kampi veror i diturisë

Vendi i mbajtjes : Caktohet më vonë.

Koha e jetësimit të projektit:

Grupi I: 8-14 korrik 2013

Grupi II: 5-11 gusht 2013

Mosha : 13-17 vjeç

Kohëzgjatja: 2 grupe nga 7 ditë

Pjesëmarrës:

Grupi I: 50 nxënës nga diaspora dhe nga 10 Kosova

Grupi II: 50 nxënës nga diaspora dhe nga 10 nga Kosova

Udhëheqës të projektit : Ymer Avdiu

Pjesëmarrës të tjerë: Sebahate Murturi, Besa Abazi

Vendi i nisjes: (Prishtinë, para Bibliotekës Kombëtare)

Data dhe koha e nisjes: caktohet më vonë

Data e vendosjes: caktohet më vonë

Data dhe koha e kthimit: Për të dy grupet caktohet më vonë **Përshkrimi i projektit:**

Me këtë synohet që të mblidhen 50 nxënës nga diaspora dhe nga 10 nga Kosova dhe të vendosen bashkërisht në kampin veror.

Në kamp do të organizohet mësimi nga gjuha dhe letërsia shqipe, historia, gjeografia, arti muzikor dhe arti figurativ, si dhe aktivitete rinore dhe kulturore.

Këto aktivitete do të jenë: edukative- arsimore, sportive, kulturore, piknik, vizita në qytete të ndryshme të Kosovës dhe Shqipërisë, aktivitete edukative kundër dhunës, alkoolit, duhanit, drogës etj.

Për të gjitha këto aktivitete duhet të angazhohen arsimtarë të lëndëve gjuhë dhe letërsi shqipe, histori, gjeografi, art figurativ dhe art muzikor.

Temat :

1. Ta njohin më afër atdheun e tyre – vendlindjen
2. Ta thellojnë mësimin e gjuhës amtare dhe të letërsisë
3. T'i njohin bukuritë natyrore, kulturore, historike të atdheut
4. Një hartim garues me temën për kampin veror në Kosovë
5. Aktivitete sportive

Aktivitetet edukative –arsimore

Punohet sipas një programi nga plan-programi nga (kurrikula e SHMP),

Organizohen mbremje shoqërore me skeçe, këngë dhe me recitime nga vetë fëmijët .

Ekskursioni njohës – mësimor “ Ta njohim Atdheun”: Vizitë në , në Prekaz, në Shpellën e Gadimes, në Kalanë e Artanës, në bifurkacionin e Nerodimes, në Grykë të Rugovës dhe në Pejë, Junik, Gjakovë , Prizren dhe në Letnicë etj, Grykën e Valbonës, një kalim me trarget nëpër Koman e Fierzë, vizitë në kalanë e Rozafatit, në Krujë, etj.

Në fund të këtij aktiviteti, fëmijëve mund t`u jepet nga një libër dhuratë, që do ta ruante kujtimin e një shoqërimi të tillë.

Duhet të jetë në dispozicion një autobus dhe një furgon për vizita në qytete të Kosovës. Programi ditor mund të mos jetë i fiksuar plotësisht, por mund të plotësohet sipas rastit.

Secili nxënës merr një certifikatë pas përfundimit të mësimit.

Lidhjet me subjektet e ndryshme:

Emri e mbiemri	Institucioni	Funksioni	Telefoni	E-mail
Sebahate Murturi	MeD	Zyrtare e lartë		
Ymer Avdiu	MeD	U.d.drejtor i DPD	+377-44 907043	Ymer.avdiu@rks-gov.net
Besa Abazi	MeD	Zyrtare në DA për diasporë	+377 44 157769	
Përfaqësues i FSK-së				
Drejtoriët e DA të komunave-bashkive, ku organizohet kampi dhe ku bëhen vizita dhe 4 mësues nga Kosova dhe 4 Shqipëria dhe nga një mësues përcjellës i nxënësve nga secili vend që vijnë				
Rifat Hamiti	KASH	Gjermani		
Hamëz Morina	LAPSH	Zvicër		
Xhevat Isufi	këshilltar i jashtëm i ministrit Makolli	Suedi-		
Agim Syla	kryetar i LASH-it	Belgjikë		

Osman Ademi	kryetar i LASH -it	Austri		
Ragip Thaqi dhe një mësuese nga Shqipëria-emigrante në Itali		Itali		
Alma Bejtullahu	Mësuese	Slloveni		
Lutfi Vata	Mësues	Angli		
Florina Lumezi	Mësuese	Kroaci		
Fikrie Bylykbashi	Mësuese	Norvegji		
Qamil Bytyçi	kryetar i shoqatës shqiptaro-turke	Turqi		
Artemis Duri	Kryetar i LM	Greqi		
Ahmet Musa,	Mësues	Finlandë		
<u>Sabri Iishi</u>	<u>Mësues</u>	<u>Danimarkë</u>		

Orari i aktiviteteve të kampit veror të diturisë

<i>Data</i>		
	Emërtimi i veprimtarisë	Vërejtje

Në Grupin e parë marrin pjesë: 3 mësues nga Kosova, nga 1 mësues nga Gjermania, Suedia, Greqia, Zvicra, Austria, Italia, Finlanda, Norvegjia, Danimarka, Sllovenia = 13 mësues

Në grupin e dytë: 3 mësues nga Kosova, nga 1 mësues nga Gjermania, Zvicra, Austria, Turqia, Italia, Belgjika, Suedia, Anglia, Franca dhe Kroacia = 13 mësues.

Nxënësit pjesëmarrës në shkollat verore i caktojnë mësuesit dhe asociacionet e mësuesve në Diasporë si LASH, LAPSH, KASH, Lidhja e Mësuesve etj.

Për mësuesit paguhet akomodimi dhe ushqimi, por jo edhe honorare

Numri i nxënësve të ftuar për dy grupet nga 50 nxënës::

12 nxënës nga Gjermania,

10 nxënës nga Zvicra,

10 nxënës nga Suedia,

4 nxënës nga Norvegjia,

2 nxënës nga Danimarka,

6 nxënës nga Finlanda,

10 nxënës nga Austria.

10 nxënës nga Italia,

6 nxënës nga Anglia,

5 nxënës nga Belgjika,

4 nxënës nga Kroacia,

2 nxënës nga Sllovenia,

4 nxënës nga Turqia.

10 nxënës nga Greqia

5 nxënës nga Franca

Në grupin e parë marrin pjesë:

6 nxënës nga Gjermania,

5 nxënës nga Zvicra,

5 nxënës nga Suedia,

4 nxënës nga Norvegjia,

2 nxënës nga Danimarka,

6 nxënës nga Finlanda,

5 nxënës nga Austria.

5 nxënës nga Italia,

3 nxënës nga Anglia,

2 nxënës nga Sllovenia,

2 nxënës nga Kroacia,

5 nxënës nga Greqia

Në grupin e dytë marrin pjesë

6 nxënës nga Gjermania,

5 nxënës nga Zvicra,

5 nxënës nga Suedia,

5 nxënës nga Austria.

5 nxënës nga Italia,

3 nxënës nga Anglia,

5 nxënës nga Belgjika,

4 nxënës nga Turqia.

5 nxënës nga Greqia

5 nxënës nga Franca

2 nxënës nga Kroacia